ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**631-25-2182-5-2-1**
Nr i brendshëm	**631 25 007 521**

Sa i përket tenderit për: "Ndërtimi i urës në Vranoc të vogël, Rastavicë dhe rregullimi i shtratit të lumit Baballoq".

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Denisi SH.P.K. & JOOS & KRASNIQI -BAZE SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Deçan, 8, Demostratave

(Adresa)

Deçan — *51000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

+38344666988

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Shkelzen Kuçi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

denisi.ntp@gmail.com

(Adresa elektronike)

19.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. "DENISI" 811297276 DEÇAN

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 21.03.2025 Data e hapjes së ofertave: 10.04.2025 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 28.04.2025 Kërkesa për rishqyrtim dt.02.05.2025 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:07.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 52 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt.28.04.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE GURI

GROUP SHPK & AGRI INVEST 1 SH.P.K., ndërsa ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Me dt.29.04.2025 ne kemi kërkuar qasje në dokumente të grupit OE të rekomanduar për kontratë. Gjatë verifikimit të dokumenteve ne kemi vërejtur se grupit të OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë dokumentet si më poshtë.

- Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar si më poshtë:

Kërkesa 2. Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore së paku nga 10 (dhjetë) punëtorë për secilin vit në tri vitet e shkuara.
Dëshmia 2. Deklaratë e mesatares së fuqisë puntore të OE,lista e punëtorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Te dëshmohet permes kontratave te punes.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar këtë kërkesë dhe ky fakt vërehet nga dëshmitë që i ka ofruar në lidhje me këtë kërkesë.

Ky grup ka ofruar dëshmi se i ka 10 apo më shumë punëtor vetëm për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 ka ofruar dëshmi se i ka pasur 8 punëtorë, kurse për vitin 2024 9 punëtorë gjithsejtë, prandaj nuk është përmbushur kërkesa që së paku nga 10 punëtorë ti ketë në secilin vit gjatë tri viteve të fundit.

- Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar si më poshtë:

Kërkesa 5. ,1(nje) Eskavator me superstrukturë rrotulluese me zinxhir me peshë totale minimum 24 t, ,1(nje)Eskavator me goma me peshë totale minimum 15t, , 1(nje) Gjysëmrimorkio për bartje te automjeteve te rënda pesha totale min 35t , 3(tre) Kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë të ngarkesës minimum 15t, 3(tre)Kamiona automikser për bartje te betonit te gatshëm, 1(një) Autopompë për hudhjen e betonit , 1(nje) Papuqe vibruese (pllake vibruese) - pesha min. 350 kg ,1(një) Damper te tonazhit te mesem-pesha min. 3 Ton , 1(një) Viberator për vibrim te betonit, 1(një) Gjenerator min 7.5 kva
Dëshmia 5. Si dëshmi Operatori ekonomik duhet të plotësojë listën e paisjeve sipas kerkeses të Dosjes së Tenderit. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik ,listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike. OE duhet të prezentoj listen me të gjitha deshmitë përkatëse (librezat e qarkullimit valide me afat te regjistrimit për automjetet që regjistrohen, ndërsa për paisjet mjetet e tjera të ofrohen dëshmi si (DUD-at ose faturat apo kontratat e shiteblerjes, etj.) Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontratë e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

Pra, është kërkuar gjysëmrimorkio për bartje të automjeteve të rënda pesha min.35 tonë, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar **Rimorkio kiper për bartje të zhavorrit dhe atë me peshë 34,200 kg.**
Shih Foton më poshtë



A	03-244-XB
I	31.05.2021
C	
C.2	
C.2.1	GURI GROUP SH.P.K
C.2.2	
C.2.3	Mbretnesha Teuta listog
B	23.04.1998
D	
D.1	Schwarzmuller
D.2	3A HKS AL
D3	M1
E	WVWZZZ122336VHS09186
S	1998
S	
S.1	
S.2	
Q	
F	34200
F1	27800
G	6400
K	
P	
P1	
P2	
P3	
R	
2A	Gjysmëmrimorkio Kiper
	SH.P.K

Nga kjo librezë kuptohet se kërkesa nuk është plotësuar për dy arsye, njëra që gjysëmrimorkio kiper është **për bartje të zhavorrit** dhe arsyeja tjetër tonazha nuk është sipas kërkesës. Gjysëmrimorkiot dallojnë sa i përket destinimeve të tyre dhe se gjysëmrimorkiot që janë për bartje të automjeteve janë të tjera me ato për bartje të zhavorrit, prandaj nuk është plotësuar kërkesa. Gjysëmrimorkiot për bartje të zhavorrit nuk ka asnjë mundësi të shfrytëzohen për bartje të automjeteve dhe anasjelltas.

Në listë të grupit të OE të rekomanduar për kontratë figuron si në vijim:

Lista e makinerive (Paisjeve) qe Kerkohen ne Projekt

Per:KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN

Nga: GURIGROUP SHPK

Projekti:Ndërtimi i urës në Vranoc të vogël, Rastavicë dhe rregullimi i shtratit të lumit Baballoq

Nr Prokurim : 631-25-2182-5-2-1

Nr.Rend. KERKESA	Lloji Kerkesa ne cope	I POSEDOJM	Ne Pronesi	E huazuar per projekt
1	Eskavator 24 t (1cope)	2 cope	2 Cope GURIGROUP SHPK	
2	Eskavator me goma 15t (1cope)	1cope	1 Cope Demaj ING SHPK	
3	GjysemRimorkio min35 t (1cope)	1 cope		1 Cope e Huazuar

Pra, është kërkuar gjysëmrimorkio për bartje të automjeteve të rënda **pesha min.35 tonë**, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar Rimorkio kiper për bartje të zhavorrit dhe atë me peshë **34,200 kg**.
Shih Foton më poshtë:

- Marrëveshja për makineri ndërmjet Guri Group SHPK me NTSH Bushi nuk i ka të cekura se cilat makineri janë të përfshira në këtë marrëveshje, e po ashtu marrëveshja nuk ka kohëzgjatje siç është kërkuar në dosje të tenderit që marrëveshja të jetë valide për periudhën sa zgjat projekti. Marrëveshja me Ar Beton SHPK i ka të cekura makineritë të cilat huazohen, ndërsa me NTSH Bushi nuk janë të cekura.

- **Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar edhe kërkesën në lidhje me kontrata dhe referenca, si në vijim:**

- Projekti "Ndërtimi i sistemit të pompimit për furnizim me ujë në ndërtesat kolektive dhe lagje, kontratë kornizë përfundon me dt.12.09.2025, ndërsa referenca është lëshuar me dt.11.03.2023 dhe nuk merret parasysh kjo referencë
- Projekti "**grumbullimi, transporti dhe trajtimi i mbeturinave inerte dhe të vëllimshme** me nr.21-2967-2-1-1 me KRM Pastrimi nuk është i ngjashëm siç është kërkuar, prandaj nuk duhet të merret parasysh, sepse ka të bëjë me grumbullim të mbeturinave.
- Njëjtë nuk duhet të merret parasysh as projekti "grumbullimi, transporti dhe trajtimi i mbeturinave inerte me nr.20-2812-2-1-1 me KRM Pastrimi sepse nuk është i ngjashëm siç është kërkuar. Po ashtu ky projekt është kryer jashtë tri viteve të fundit.

Projektet e cekura më poshtë të Agro Invest 1 janë jashtë periudhës trevjeçare dhe nuk janë të ngjashme, prandaj nuk merren parasysh:

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Data e përfundimit te kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	Nurmi i telefonit te Blerësit
1.	Intervenimi dhe mirëmbajtja ne pompa, kanalizimi atmosferik, fontana, kroje publike monumente dhe mure rezistuese-Loto-1-re	24/07/2020	08/10/2021	103'987.40 €	Komuna e Prishtinës	038-244-613
2.	Pastrimi i shtratit të Lumenjëve, portave hyrëse në kolektor, kanalit atmosferik dhe zëvendësimi I kapakëve të pusetave	02/10/2019	22/09/2020	123'738.42 €	Komuna e Prishtinës	038-244-613

Kontrata e cekur më poshtë nuk është e natyrës së ngjashme.

3	Shtrimi me zhavor i rrugëve në Komunën e Prishtinës	13/12/2022	01/06/2023	84'565.00 €	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	038- 230-900

Kontrata e shënuar më poshtë është jashtë trevjeçarit:

6.	**Grumbullimi, Transporti dhe Trajtimi I Mbeturinave Inerte**	07/09/2020	20/05/2021	**174'000.00 €**	KRM Pastrimi	038-603-724

Kontratat e cekura më poshtë janë në implementim e sipër dhe nuk merren parasysh:

7.	**Rregullimi dhe zgjerimi i kanaleve atmosferike përgjatë rrugëve në fshatrat e Shtimes dhe në Shtime**	13/12/2022	Në implementim e sipër	**24'344.25 €**	Komuna Shtime	0290-389-016-228
8.	**Rrenimi i objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit**	08/12/2021	Në implementim e sipër	**54'650.00 €**	Kuvendi Komunal Rahovec	038/200-45316
9.	**Trajtimi i shtretërve të përrenjve në Komunën e Rahovecit- faza e dytë**	24/11/2021	Në implementim e sipër	**246'723.39 €**	Kuvendi Komunal Rahovec	038/200-45316

- Referenca e lëshuar nga "te **Mili SHPK** për Guri Group SHPK nuk ka vlerë të punëve të kryera dhe dyshojmë që nuk është e vërtetë.
- Kontrata e lidhur ndërmjet Guri Group dhe Shtepija G SHPK nuk ka referencë e as procesverbal përfundimtar.
- Kontrata me titull " Ndërtimi i murit mbrojtës në stacionin policor Skenderaj" ka certifikatë të përkohshme.
- Kontrata e Guri Group me Eurostil SHPk ka të bëjë me rrënim ët objekteve dhe nuk duhet të merret parasysh. Po ashtu pagesat nuk dihet se si janë bërë dhe a janë bërë dhe ne dyshojmë që kjo kontratë është e realizuar pavarësisht se nuk është e natyrës së ngjashme.
- Edhe kontrata e lidhur ndërmjet Agro invest 1 me Guri Group SHPK ka të bëjë me rrënim të objekteve dhe nuk duhet të merret parasysh.
- Kontratat e lidhura nga Guri Group me KRU Hidro Drini nuk kanë referenca e a procesverbale përfundimtare prandaj nuk duhet të merren parasysh.
- **Kontratat e mëposhtme nuk kanë referenca e as procesverbale përfundimtare dhe nuk janë të natyrës së ngjashme.**

18	AMKMK	NDËRTIMI I MEMORIALIT TË DESHMORVE TË BRIGADES 136 RUGOVA NË PEPAJ TË RUGOVES - PEJË	207-AMMKM-24-5489-521	C49	2024	96,814.40 €
19	QK DUBRAVE	RENOVIMI I KULMIT TË TEATRIT NË QENDRËN KORREKTUESE DUBRAVE	33600-24-6257-5-2-1	C280	2024	52,720.00 €

Edhe kontratat e tjera janë jashtë natyrës së kërkuar, pasi që kanë të bëjnë me eliminim të deponive, siç është kontrata me nr. rendor 7, 15, 16 (të listuara tek lista e Guri Group SHPK).

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që nuk e arrin vlerën e kërkuar prej 400 mijë euro me kontrata të ngjashme, sepse disa kontrata janë jashtë trevjeçarit të fundit, disa nuk janë të natyrës së ngjashme e disa të tjera nuk kanë dëshmi se janë përfunduar ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Ju lutem analizojeni në tërësi këto dëshmi për kontratat e ofruara.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerr me dt.07.05.2025.
Në lidhje me pretendimin Nr.1 autoriteti kontraktues është përgjigjur si më poshtë:

Përgjigje në Pretendimin 1.

Ky pretendim nuk qëndron për aryse se pas kërkesës për sqarim te datës 18.04.2025 ndaj OE të shpallur fitues ka dëshmuar se posedon dëshmi duke i prezentuar përmes platformës elektronike mbrenda afatit ligjor.Andaj ky pretendim është i pabazuar.

Neve me qasje nuk na është dhënë asnjë dëshmi tjetër shtesë përveç atyre që i kemi cekur e ku kjo kërkesë nuk plotësohet, prandaj përderisa nuk dëshmohet e kundërta, ne konsiderojmë se kërkesa nuk është plotësuar dhe se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Në lidhje me pretendimin Nr.2 autoriteti kontraktues është përgjigjur si më poshtë:

Përgjigje në Pretendimin 2.

Ky pretendim nuk qendron **për arsye se komisioni vlersues ka vlersuar se OE I shpallur fitues ka marreveshje dhe dëshmi për makineri .Andaj ky pretendim është I pabazuar.**

Sa i përket gjysëmrimorkios së kërkuar për bartje të automjeteve me peshë min 35 ton, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar për bartje të zhavorrit dhe atë me peshë 34.200 kg, sipas kësaj përgjigje të AK-së kuptohet se pretendimi jonë është i bazuar, pasi që AK-së nuk ka arrit të argumentojë të kundërtën por ka dhënë përgjigje të përgjithësuar pa asnjë argument.
Në lidhje me pretendimin Nr.3 autoriteti kontraktues është përgjigjur si më poshtë:

Përgjigje në Pretendimin 3.

-Ju rikujtojmë se Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP) për zhvillimin e procedurës për projektin : Ndërtimi i urës në Vranoc të vogël, Rastavicë dhe rregullimi i shtratit të lumit Baballoq .ka qenë me nr 45000000-7 ***që nënkupton (Punë ndërtimi) dhe që përshtatet edhe me vet titullin dhe me referencat e prezentuara nga OE i shpallur fitues.Andaj ky pretendim është i pa bazuar.***

Edhe kjo përgjigje është e pa argumentuar por është përgjigje e përgjithësuar vetëm sa për të mbështetur vendimin e tyre autoriteti kontraktues. Më lartë ne e kemi cekur dhe sqaruar në detaje se kjo kërkesë nuk plotësohet nga ana e OE të rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me pretendimin Nr. 3, autoriteti kontraktues është përgjigjur si më poshtë:

Përgjigje në Pretendimin 3.

-Ju rikujtojmë se Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP) për zhvillimin e procedurës për projektin : Ndërtimi i urës në Vranoc të vogël, Rastavicë dhe rregullimi i shtratit të lumit Baballoq .ka qenë me nr 45000000-7 ***që nënkupton (Punë ndërtimi) dhe që përshtatet edhe me vet titullin dhe me referencat e prezentuara nga OE i shpallur fitues.Andaj ky pretendim është i pa bazuar.***

Ky arsyetim i KA-së nuk është i drejtë dhe në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit, pasi që tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar si më poshtë:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara nga publikimi i njoftimit për kontratë në vlerë prej jo më pak se 400,000.00€

Pra kërkesa ka qenë të ofrohen dëshmi për kontrata të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa kontrata të cilat ne i kemi cekur më lartë nuk kanë të bëjnë fare me këtë

aktivitet të prokurimit, prandaj ky arsyetim është jo profesional dhe i njëanshëm në interpretim të kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që dëshmitë e ofruara duhet të vlerësohen në raport me kërkesat e dosjes së tenderit e jo me fjalorin e përgjithshëm të prokurimit.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**, siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Denisi SH.P.K. & JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në
RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*